



QËNDRA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM  
Center for Research and Development  
Rruga: "Luigj Gurakuqi", PO Box 218/1, Tirana  
Tel: +355 (0)4 230 445  
Mobile: 0682043852  
E-mail: qkzhtir@icc-al.org

# **Studim mbi Integrimin e Rinisë në Tregun e Punës: Pengesat dhe Vështirësitë**

Përgatitur nga:

**QËNDRA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM**

Realizuar nën mbështetjen financiare të:

**Fondacionit për një Shoqëri të Hapur, Tiranë**

<b>Lënda:</b>	
Lista e figurave	3
<b>Kapitulli i parë</b>	
<b>Qëllimi, objektivat dhe metodologjia e përdorur</b>	5
1.1. Qëllimi i kryerjes së këtij studimi	5
1.2. Objektivat e projektit	5
1.3. Metodologjia e përdorur	6
1.3.1 Përgatitja e pyetsorit	6
1.3.2 Ndërtimi i kampionit të të anketuarve	7
1.3.3 Përpunimi i rezultateve	7
<b>Kapitulli i dytë</b>	
<b>Shpërndarja e të anketuarve dhe situata e punësimit</b>	8
2.1. Karakteristikat kryesore të kampionit të përzgjedhur për anketim	8
2.2. Situata e përgjithshme e punësimit	9
2.2.1. Shpërndarja e të rinjve në marrëdhënie pune	9
2.2.2 Shpërndarja e të rinjve që janë aktualisht të pa punë	11
<b>Kapitulli i tretë</b>	
<b>Diagnostikimi i çështjeve të punësimit</b>	12
3.1 Analiza e kohës së punës	12
3.2. Analiza e pagës	16
3.3. Gadishmëria për të kërkuar punë të re	18
<b>Kapitulli i katërt</b>	
<b>Natyra e papunësisë dhe përpjekjet për tu punësuar</b>	21
4.1. Analiza e të papunëve që nuk kërkojnë punë	21
4.2. Karakteristikat e “rezervuarit” të të papunëve	23
4.3. Kualifikimi i të rinjve të papunë	24
4.4. Mënyrat e kërkimit të punës	25
4.5. Fleksibiliteti për të udhëtuar në një punë të re	26
<b>Kapitulli i pestë</b>	
<b>Konkluzione dhe rekomandime</b>	29

## Lista e figurave

FIGURA 1:	Shpërndarja e të anketuarve sipas grup moshave / <i>Respondents distribution by age</i>	8
FIGURA 2:	Shpërndarja e të anketuarve sipas gjinisë / <i>Respondents distribution by gender</i>	8
FIGURA 3:	Shpërndarja e të anketuarve sipas arsimit / <i>Respondents distribution by education</i>	8
FIGURA 4:	Shpërndarja sipas rretheve / <i>Respondents distribution by districts</i>	9
FIGURA 5:	Gjëndja aktuale e punësimit të të anketuarve / <i>Employment status of respondents</i>	9
FIGURA 6:	Lloji i punësimit / <i>Working type</i>	10
FIGURA 7:	Shpërndarja e të punësuarve sipas moshës / <i>Distribution of employees by age</i>	10
FIGURA 8:	Shpërndarja e të punësuarve sipas arsimit / <i>Distribution of employees by education</i>	10
FIGURA 9:	Shpërndarja e të rinjve papunë sipas grup-moshave / <i>Distribution of unemployed youth by age</i>	11
FIGURA 10:	Shpërndarja e të papunëve sipas gjinisë / <i>Distribution of unemployed youth by gender</i>	11
FIGURA 11:	Shpërndarja e të papunëve sipas arsimit / <i>Distribution of unemployed youth by education</i>	11
FIGURA 12:	Koha e zënë me punë në një javë (në orë) / <i>Working hours in one week</i>	12
FIGURA 13:	Shpërndarja sipas grup -moshave të atyre që punojnë mbi 30 orë / <i>Age distribution for employees working above 30 hours</i>	12
FIGURA 14:	Shpërndarja sipas arsimit të atyre që punojnë mbi 30 orë / <i>Education distribution for employees working above 30 hours</i>	13
FIGURA 15:	Shpërndarja sipas gjinisë të atyre që punojnë mbi 30 orë / <i>Gender distribution for employees working above 30 hours</i>	13
FIGURA 16:	Koha e zënë me punë në një javë (në ditë) / <i>Working days in one week</i>	13
FIGURA 17:	Puna me turne / <i>Working on shifts</i>	14
FIGURA 18:	Shpërndarja sipas gjinisë të atyre që punojnë me turne / <i>Gender distribution for youth working on shifts</i>	14
FIGURA 19:	Punë nate / <i>Working on night shift</i>	14
FIGURA 20:	Tejkalimi i kohës normale të punës / <i>Frequency of working above regular hours</i>	15
FIGURA 21:	Shpërndarja sipas grup-moshave të të rinjve që punojnë mbi kohën normale të punës / <i>Age distribution for youth working above regular hours</i>	15
FIGURA 22:	Shpërndarja sipas arsimit të të rinjve që punojnë mbi kohën normale të punës / <i>Education distribution for youth working above regular hours</i>	15
FIGURA 23:	Shpërndarja sipas gjinisë të të rinjve që punojnë mbi kohën normale të punës / <i>Gender distribution for youth working above regular hours</i>	16
FIGURA 24:	Preferencat nëse diskutohen çështjet e pagës / <i>Preferences if a wage increase is in question</i>	16
FIGURA 25:	Preferenca për rritjen e kohës së punës nëse ofrohet pagë më e lartë / <i>Working much more if a wage increase is offered</i>	17
FIGURA 26:	Shpërndarja sipas grup-moshave të të rinjve që pranojnë të punojnë më shumë për një pagë më të lartë / <i>Age distribution for youth that accept to work much more if the wage increases</i>	17
FIGURA 27:	Shpërndarja sipas arsimit të të rinjve që pranojnë të punojnë më shumë / <i>Education distribution for youth that accept to work much more if the wage increases</i>	17
FIGURA 28:	Shpërndarja sipas gjinisë të të rinjve që pranojnë të punojnë më shumë / <i>Gender distribution for youth that accept to work much more if the wage increases</i>	18
FIGURA 29:	Drejtimet e mundshme të punës jashtë kohës normale kundrejt për një pagë më të mirë / <i>Possible directions of working out of regular time if a wage increase is offered</i>	18
FIGURA 30:	Të rinjtë e punësuar me kohë të plotë që preferojnë të kenë një punë me kohë të pjesëshme / <i>Full-time employed youth that are looking for a part-time job</i>	19
FIGURA 31:	Të rinj që janë në punë dhe që kërkojnë punë të re / <i>Employed youth that are looking for a new job</i>	19
FIGURA 32:	Të rinj që janë në punë, kërkojnë punë dhe kanë kualifikim profesional / <i>Professional qualification for employed youth that are looking for a new job</i>	19
FIGURA 33:	Të rinj që janë në punë, kërkojnë punë dhe janë të përgatitur të punojnë në një rreth tjetër / <i>Labor mobility among employed youth and are looking for a new job</i>	20
FIGURA 34:	Kërkesë për punë / <i>Looking for a job</i>	21
FIGURA 35:	Shpërndarja sipas grup - moshës e të papunëve që nuk kërkojnë punë / <i>Age distribution of youth who are not looking for a job</i>	22
FIGURA 36:	Shpërndarja e të papunëve që nuk kërkojnë punë sipas gjinisë / <i>Gender distribution of the</i>	22

	<i>youth who are not looking for a job</i>	
FIGURA 37:	Shpërndarja e të papunëve femra që nuk duan punë sipas arsimit / <i>Unemployed females who are not looking for a job by education</i>	22
FIGURA 38:	Numri i të qenit papunë në 5 vitet e fundit / <i>The number of unemployments situation in the last 5 years</i>	23
FIGURA 39:	Të papunë që kanë qënë papunë me shumë se një muaj në 5 vitet e fundit / <i>Distribution of unemploment for more than one month</i>	23
FIGURA 40:	Të papunë me shumë së një muaj në 5 vitet e fundit (sipas grup-moshave) / <i>Distribution of unemployed youth by ages</i>	24
FIGURA 41:	Të papunë me shumë se një muaj në 5 vitet e fundit sipas arsimit / <i>Distribution of unemployed youth by education</i>	24
FIGURA 42:	Kualifikimi profesional i të rinjve papunë / <i>Professional qualification of unempliyed youth</i>	24
FIGURA 43:	Lloji i kualifikimit për të rinjtë e papunë / <i>Type of qualification for unemployed youth</i>	25
FIGURA 44:	Koha e kualifikimit profesional për të rinjtë e papunë / <i>Timing of profesional qualification for ynempliyed youth</i>	25
FIGURA 45:	Si kërkohet informacioni për punë nga të rinjtë e papunë / <i>How the information for new job-openings is looking for by the unemployed youth</i>	25
FIGURA 46:	Si tentohet për t'u punësuar nga të rinjtë që kërkojnë punë / <i>What actions are being undertaken by youth to require a new job</i>	26
FIGURA 47:	Gadishmëria për të punuar në një rreth tjetër / <i>Mobility of unemployed youth</i>	26
FIGURA 48:	Sa kohë në ditë pranojnë të udhëtojnë për punë / <i>Labor mobility by traveling hours in a day</i>	27
FIGURA 49:	Shpërndarja sipas moshës e të papunëve duan punë dhe që pranojnë të shkojnë në një rreth tjetër /	27
FIGURA 50:	Shpërndarja sipas arsimit e të papunëve duan punë dhe që pranojnë të shkojnë në një rreth tjetër /	27
FIGURA 51:	Shpërndarja sipas gjinisë e të papunëve duan punë dhe që pranojnë të shkojnë në një rreth tjetër /	28

### Qëllimi, objektivat dhe metodologjia e përdorur

#### 1.1. Qëllimi i kryerjes së këtij studimi

Ky projekt ka për qëllim të bëjë një analizë të hollësishme dhe reale të problemeve që ka Rinia sot për tu integruar në tregun e punës. Më konkretisht ai synon të analizojë perspektivën dhe synimet që ka Rinia në kushtet kur janë të punësuar dhe jo të punësuar, duke diagnostikuar raportet që ekzistojnë ndërmjet Rinisë si të punësuar me punëdhënësit, si dhe mënyrën dhe problematikën që ka Rinia për të hyrë në tregun e punës.

Metoda e mbledhjes së informacionit u krye me anë të një anketimi, ndërsa përpunimi i të dhënave është përfaqësuese, sipas grupeve më të rëndësishme dhe qytetit të Tiranës. Përzgjedhja e të rinjve u krye në mënyrë të rastësishme sipas kriterëve të paracaktuara, për grup moshat nga 16 – 28 vjeç dhe u shtri në zonat më të rëndësishme urbane, Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, dhe Vlorë. Rezultatet e këtij projekti mendojmë se do t'i shërbejnë, institucioneve publike për përmirësimin e politikave të punësimit, organizatave të tjera jo qeveritare si platformë dialogu me lobet e tjera, shoqatave të rinisë si dhe vetë biznesit, për të kuptuar perspektivat dhe synimet e grupit më të rëndësishëm të popullsisë, siç është Rinia.

Nisur nga të dhënat e fundit të shpërndarjes së popullsisë sipas grup moshave të vitit 2000, pavarësisht nga “një farë plakje”, popullsia e Shqipërisë është nga më të rejat dhe grup moshë e rinisë është determinante nga të gjitha grup moshat e tjera të popullsisë. Ky fakt vazhdon ta bëjë Shqipërinë një vend mjaft atraktiv dhe me potenciale mjaft të mëdha për rritjen ekonomike dhe thithjen e investimeve të reja vëndase apo të huaja.

Nga zhvillimet e dhjetë-viteve të fundit rezultoi se ky potencial mjaft i rëndësishëm jo vetëm që nuk është përdorur sa duhet për tër mirën e gjithë shoqërisë Shqiptare, por ka tendencë për politika spontane në integrimin e rinisë në tregun e punës. Për më tepër në Shqipëri mungon një bazë informacioni në lidhje me kushtet dhe perspektivat e punësimit, sektorët potencialë, profesionet më të kërkuara dhe shpërndarjen gjeografike të punësimit. Po kështu, informacioni nga vetë grupi i popullsisë në moshë të re për perspektivën, kërkesat që ata kanë **si në kushtet kur ata janë në marrëdhënie pune, por për më tepër** kur ata janë duke kërkuar për të është mjaft e vogël.

Pikërisht, ky projekt tenton të plotësojë tematikën që lidhet me dy çështjet e fundit, d.m.th. plotësimin e boshllëkut informativ në lidhje me integrimin e Rinisë në tregun e punës dhe përpunimin e rekomandimeve përkatëse në bazë të analizave të informacionit të mbledhur dhe përpunuara në kuadrin e këtij projekti. Informacioni i mbledhur u përpunua në një formë mjaft të lexueshme për një nivel sa më të gjerë dhe ju shpërnda të gjitha institucioneve dhe organizmave më përfaqësuese publike dhe të shoqërisë civile. Në vijim të këtij studimi, Qendra po përgatit një sërë artikujsh dhe broshurën përkatëse me konkluzionet kryesore që dolën nga ky projekt.

#### 1.2. Objektivat e projektit

Me anë të këtij projekti u synua të realizoheshin objektivat e mëposhtme:

1. Të zhvillohej një metodologji standarte për të matur shkallën e perceptimit të rinisë në lidhje me kushtet e punës, pagën mesatare, kohën e punës dhe nevojat e reja për kualifikime. Së dyti, të sigurohej përpunimi i një standarti për të vlerësuar përpjekjet dhe vështirësitë që ka Rinia për të hyrë në tregun e punës. Së treti, metodologjia e përdorur të siguronte një informacion për besueshmërinë e Rinisë për të siguruar kushte më të mira jetese. Së fundi, kjo metodologji të mbështetej mbi standartet ndërkombëtare të vlerësimit të tregut të punës dhe të sigurojë krahasueshmërinë së të dhënave në kohë dhe ndërmjet vëndeve të tjera.
2. Të zhvillonte një sistem indikatorësh për të ndjekur ecurinë e zhvillimit dhe perspektivës së Rinisë.

3. Të mbledhë dhe përpunojë informacionin në bazë të indikatorëve dhe metodologjisë së përgatitur në kuadër të këtij projekti.
4. Të vlerësojë dhe analizojë situatën e punësimit në grupin e Rinisë dhe të vlerësojë faktorët që kanë ndikuar në nxitjen apo pengimin e Rinisë për tu integruar në tregun e punës.
5. Të nxisë debatin dhe dialogun ndërmjet institucioneve publike, shoqatave të biznesit dhe organizatave të shoqërisë civile në lidhje me nxitjen e punësimit, ndërtimin e politikave reale dhe konkrete të punësimit dhe rritjen e perspektivës së Rinisë për tu integruar në jetën ekonomike dhe sociale të Shqipërisë.

Ky projekt u bazua mbi një metodologji që lejon krijimin dhe përdorimin e disa indikatorëve që do të mundësojnë krahasueshmërinë e rezultateve në kohë dhe në vënde të ngjashme me Shqipërinë. Për rrjedhojë kjo do të lejoj që nga ana jonë, apo organizata të tjera të ngjashme me misionin e Qendrës sonë të përdoret metodologjia dhe indikatorët si një hap fillestar për krahasueshmërinë e të dhënave në periudha të ndryshme kohore. Kjo do të fuqizoj akoma më shumë bazën e informacionit për zhvillimin e tendencave në lidhje me perspektivën e Rinisë për tu integruar në tregun e punës, si dhe për të ndërtuar rekomandime më të plota në lidhje me këtë çështje mjaft të rëndësishme.

### 1.3. Metodologjia e përdorur

Projekti që bazohet në mbledhjen e informacionit mbi bazë të një anketimi, kërkon në radhë të parë të përcaktohen qartë objektivat dhe indikatorët. Mbi bazën e saj ndërtohen: (1) pyetsori, që të mbulojë gjithë gamën e informacionit që kërkohen 2) përcaktohen kriteret mbi të cilët do të pëzgjidhen subjektet që do të anketohen; si dhe (3) përcaktohen kriteret e vlerësimit dhe paraqitjes së rezultateve të anketimit. Më poshtë do të ndalemi në të tre këto momente të rëndësishme.

#### 1.3.1 Përgatitja e pyetsorit

Nisur nga natyra e këtij projekti, si dhe për realizimin sa më mirë të objektivave të tij, përgatitja e plote e pyetsorit kerkoi një pjesë të veçantë të kohës së zbatimit të këtij projekti. Pyetsori i përgatitur u nda në pesë seksione me këto përmbajtje.

#### Seksioni i parë: *Pyetjet verifikuese*

Me anë ketyre pyetjeve u identifikua:

- Grup moshë ku bën pjesë i anketuari
- Aresimi
- Gjendja e punësimit
- Seksi
- Qyteti
- Natyra e punës që kryente (i punësuar, apo i vetëpunësuar)

Ne rast se i anketuari ishte nxënës apo student dhe nuk punonte në asnjë lloj forme intervistat konsiderohej e mbyllur, pasi si, “*target*” grup ishte ajo pjesë e Rinisë, e cila ishte:

- duke kerkuar punë për herë të parë
- i papunë
- i punësuar në sektorin privat.

#### Seksioni i dytë: *Kushtet e punës dhe kërkesat e reja.*

Me këto pyetje u mblodhën informacioni në lidhje me:

- kohën e punës
- tendencat për rritjen e pages
- ditët e punës

- kushtet e punes

Pyetjet per personat qe kerkojne pune.

#### **Seksioni i trete: *Perpjekjet per te kerkuar pune.***

Me ane te ketyre pyetjeve shikohet se cilat jane perpjekjet e Rinise per te kerkuar pune dhe menyres se si e kerkon ai mundesine per te gjetur pune.

#### **Seksioni i katert: *Pengesat qe shikohen per pune te reja.***

Nga veshtiresitë që mund të ketë Rinia në kushtet e sotme mund të përmenden:

- Mungesa e ofertes per vende te reja pune
- Informacioni jo i plote per vendet e reja
- Kosto e transportit
- Nuk perputhet kualifikimi

#### **Seksioni i peste: *Përcaktimi i nevojave për tu integruar në tregun e punes***

Kerkesat e reja qe mund te kerkohen nga shtrasa e Rinise per tu integruar ne tregun e punes, mund te jene:

- Rritja e kualifikimit
- Kerkesa per informacion shtese
- Trajnimi se si te organizohet intervistat e punës

#### **1.3.2 Ndertimi i kampionit te te anketuarëve**


Për t'ju pergjigjur kerkesave per te marre nje informacion sa me perfaqesues, numri i të anketuarve të u zgjodh rreth 500 të rinj. Perzgjedhja e tyre do te behet vetem ne zonat urbane dhe do te perfshije qytetet kryesore te vendit si Tirana, Durresi, Shkodra, Elbansani, dhe Vlora. Po keshtu do te shikohet nje shperndarje e barabarte e Rinise sipas gjinise. Përcaktimi i saktë i kampionit të të anketuarve per çdo zone urbane do te behet pas hedhjes se shortit, por do te kihet parasysh ne radhe te pari kriteri i popullise per çdo qender te banuar dhe perpjestimi i tyre ndaj njera tjetres.

#### **1.3.3 Përpunimi i rezultateve**

Natyra e pergjigjeve në pyetsorin qe do te pregatitet do jete cilesor. E cila nenkupton nje pergjigje te caktuar ne kuadrin e 3 deri 5 mundesive. Per te vleresuar pergjigjen e pergjithshme per nje pyetje te caktuar u perdor nje instrument i veçante qe quhet Balanca, qe tregon diferencen ne perqindje ndermjet pergjigjeve pozitive dhe negative per nje pyetje te caktuar. Përgjigjet që tregojnë një gjëndje të pandryshuar nuk u merren ne konsideratë.

#### 2.1. Karakteristikat kryesore të kampionit të përzgjedhur për anketim

Sic u theksua edhe në kapitullin e parë, përzgjedhja e kampionit u krye në mënyrë të rastësishme me kontakte të drejtpërdrejta. Nga përpunimi i të dhënave rezultoi se nga totali gjithsej, 20% e të anketuarëve bëjnë pjesë në grup moshën 16-18 vjeç, 40% në grup-moshën 19-23 vjeç dhe pjesa tjetër të grup moshës 24-28 vjeç (shiko figurën 1).



Nga figura 2 shikohet se në total meshkujt e intervistuar zënë rreth 50,5% ndërsa femrat rreth 49,6% të të intervistuarëve, çka tregon një përzgjedhje mjaft të mirë sipas gjinisë të të anketuarëve, në kontekst me shpërndarjen demografike në rang kombëtar si dhe qytetet e përzgjedhura.






Figura 3 tregon shpërndarjen e të anketuarëve sipas arsimit. Nga figura rezultoi se nga totali i të anketuarëve rezultoi se 30% kanë vetëm arsimin 8-vjeçar, 48% arsimin e mesëm dhe 22% kanë përfunduar arsimin





universitar.

Shpërndarja gjeografike e të anketuarave tregohet në figurën 4. Nga totali i të intervistuarve rreth gjysma e tyre janë intervistuar në Tiranë, 14 % në Durrës dhe pjesa tjetër në mënyrë të barabartë prej 12 % është pjesa e intervistuar në qytetet e tjera të Shqipërisë, Elbasan, Shkodër dhe Vlorë.



Si konkluzion mund të thuhet se nga të dhënat e paraqitura në 4 figurat e para duket mjaft qartë se kampioni i përzgjedhur është mjaft përfaqësues, si përsa i përket gjinisë, por edhe shtrirjes gjeografike, arësimit dhe moshës, gjë që rrit konfidencën për treguesit e tjerë të llogaritur në bazë të kampjonit të përzgjedhur në këto anketë.

## 2.2. Situata e përgjithshme e punësimit

### 2.2.1. Shpërndarja e të rinjve në marrëdhënie pune

Nga përpunimi i të dhënave në lidhje me punësimin rezultoi se nga të gjithë të anketuarit (duke përjashtuar ndikimin e atyre që ndjekin shkollën), 72 % e tyre ishin në marrëdhënie pune ose të vetëpunësuar, ndërsa 28 % ishin aktualisht të papunë (figura 5). Me këtë rast duhet theksuar se shifra 28 % nuk përfaqëson shkallën e përgjithshme të papunësisë ndërmjet të rinjve, por vetëm të asaj pjesë që janë zgjedhur në këtë kampjon anketimi. Për të siguruar të dhëna mbi shifrën e punësimit ndërmjet të rinjve duhen kryer anketime shumë me të zgjeruara dhe me përfaqësues për të gjitha rajonet dhe zonat e Shqipërisë.







Figura 6 tregon se nga te rinjte qe jane ne pune, pjesa me e madhe e tyre ose 86% jane te punesuar me kohe te plote pune dhe vetem 14 % jane te punesuar me kohe te pjesshme.



Shperndaraja e te rinjve sipas moshes paraqitet ne figuren 7. Nga figura shikohet se shperndarja e te punesuarve sipas moshes i pergjigjet shperndarjes totale te kampjonit te perzgjedhur.



Ne figuren 8 paraqiten shperndarja e te rinjve te punesuar sipas edukimit. Nga figura rezulton se 26% e te intervistuarve qe jane ne marredhenie pune kane aresimin 8-vjecar, 47 % kane aresimin e mesem dhe 27% ate te larte universitar.



## 2.2.2 Shperndarja e te rinjve qe jane akrualisht pa pune

Sic u theksua nga totali i te rinjve te intervistuar 28% e tyre aktualisht jane pa pune (figura 5). Ne kete seksion do te paraqitet shperndarja e pergjithshme e tyre.

Ne figuren 9 paraqitet shperndarja e te rinjve pa pune sipas moshes. Nga perpunimi i te dhenave rezulton se 20 % e te papuneve jane ne moshen 1-18 vjec, 38 % te moshes 19-23 vjec dhe 42% e tyre ne moshen 24-28 vjec.






Figura 10 tregon nje te dhene interesante. Shperndarja e te papuneve sipas gjinise tregon se 55% e tyre jane femra dhe vetem 45% meshkuj, qe paraprakisht tregon se te rinjte jane me te integruar ne tregun e punes se sa te rejat.



Shperndarja e te papuneve sipas aresimit tregohet ne figuren 11. Nga perpunimi i te dhenave del se 43% e te papuneve jane perfunduar vetem aresim 8-vjecar, 45 % te tyre ate te mesem dhe te rinjte qe kane perfunduar universitetin zene vetem 12% te totalit.



Duke krahasuar te dhenat qe paraqiten ne figuren 11 me ato te figures 3, del se megjithese te rinjte e intervistuar me aresimin 8-vjecar zene vetem 30%, ata kane nje papunesi prej 43%. Po te vazhdohet kjo analize me dy grupet e tjera del lehtesisht konkluzioni se niveli i aresimit eshte ne perpjestim te zhdrejte me punesine, pra sa me larte ne shkallen e edukimit ndoshen te rrinjte aq me pak jane shancet per te qene te papune.

### 3.1. Analiza e kohes se punes

Analiza e kohes se punes eshte nje nga ceshtjet me te rendesishme ku analizohet problematika e tregut te punes, pasi ka te beje si me kerkesen dhe oferten per vende te reja pune, po ashtu ajo eshte e lidhur edhe me pagen mesatare dhe tendencat e saj ne te ardhmen, te cilat jane baze per parashikimet makroekonomike te cmimit te fuqise punetore dhe te inflacionit.

Figura 12 tregon shperndarjen e te rinjve te punesuar sipas oreve te punes qe punojne ne nje jave. Nga figura verehet se me shume se gjysma e te intervistuarve, ose 58% e tyre theksojne se punojne mbi 45 ore ne jave, 30% punojne nga 30-45 ore, 7% tregojne se punojne 20-29 ore dhe vetem 5% e te anketuarve ne marredhenie pune punojne nen 20 ore ne jave. Nga keto te dhena kuptohet se pjesa me e madhe e te rinjve te punesuar punojne mbi kohen normale, qe llogaritet ne rreth 40-45 ore ne jave, kjo tregon se fleksibiteti per te rritur kohen normale te punes ndermjet te rinjve aktualisht eshte i ulet, cka mund te rezultoje ne rritjen e pages mesatare, ne rast se te papunet nuk gjejne rruget e duhura per tu integruar ne tregun e punes.






Figura 13 tregon shperndarjen sipas moshave te te rinjve qe punojne mbi 30 ore ne jave. Nga figura duket se mbi 30 ore punojne me shume te rinjte e grup-moshave 19-28 vjec, me nje rritje relative te grup moshes 24-28, cka tregon se mosha eshte ne perpjestim te drejte me kohen e punes javore.



Po te gjykosh mbi bazen e shperndarjes sipas moshes se atyre qe punojne mbi 30 ore ne jave, shikon se shkolla eshte ne perpjestim te zhdrejte me kohen e punes, d.m.th. sa me i ulet eshte niveli aresimor aq me e larte eshte perqindja e te rinjve qe punojne mbi 30 ore ne jave. Keshtu nga figura 14 shikohet se 48 % e atyre qe kane aresim të mesem punojne mbi 30 ore ne jave kundrejt 24 % te atyre me shkollë te larte.



Shperndarja e te rinjve sipas gjinise tregon se pak a shume si te rinjte edhe te rejat kane nje shperndarje te barabarte te kohes se punes mbi 30 ore ne jave (shiko figuren 15).






Figura 16 tregon shperndarjen ne perqindje te kohes se zene me pune ne nje jave. Nga figura shikohet se mbi 73 % e te rinjve punojne 6 dhe 7 dite te javes, nga te cilat 37 % deklarojne se punojne pa asnje dite pushimi ne jave. Vetem 22 % e te rinjve deklarojne se punojnezakonisht 5 dite ne jave, dhe vetem rreth 4 perqind punojne 3-4 dite javes. Duke krahasuar te dhenat mbi oret dhe ditet e punes ne jave (pra figurat 16 dhe 12), mund te nxiret konkluzioni, se te rinjte kane nje shfrytezim intensiv te kohes se punes se sa intensiv, ne kuptimin qe ata jane te ngarkuar me shume me dite pune gjate javes se sa ore pune gjate dites.




Duke i riorganizuar te dhenat per ata qe punojne mbi 5 dite te javes sipas grup-moshave, aresimit dhe gjinise, arrihet pak a shume ne te njejtat rezultate si ne ato kur u analizuan oret e punes ne jave, d.m.th. ditet e punes jane ne perpjestim te drejte me moshen dhe ne perpjestim te zhdrejte me aresimin, ndersa perqindja sipas gjinise eshte pothuajse e barabarte per femrat dhe meshkujt, si ne rastin e kohes se punes se llogaritur me ore javore.


Figura 17 paraqet nje aspekt te vecante te organizimit te kohes se punes nga te rinjte dhe pikerisht punen me turne. Pyetjes ne se punojne me turne i pergjigjen “as nje here” 78 % e te intervistuarve, ndersa vetem 18 perqind pranojne se punojne zakonisht me turne.




Duke analizuar me ne brendesi kete problem rezulton se nga te intervistuarit qe kane theksuar se punojne zakonisht me turne, 60 % jane te reja dhe vetem 40 % te rinj (figura 18).



Puna naten duket se nuk eshte fare e preferuar per te rinjte, pasi vetem 3 perqind e te intervistuarve deklarojne se punojne zakonisht ne turnin e nates, ndersa 92 perqind e te rinjve ne marredhenie pune deklarojne se nuk kane punuar asnje here ne turnin e nates (figura 19).



Kohen normale te punes ditore e tejkalojne 29 % e te intervistuarve. Figura 20 tregon gjithashtu se 25 perqind e tejkalon ne menyre jo te regullt kohen normale te punes, ndersa 46 perqind punojne brenda kohes normale te punes.



Analiza e metejshme e kohes se punes vazhdon me klasifikimin e informacionit per ata qe tejkalojne ne menyre te regullt kohen e punes. Figura 21 tregon shperndarjen sipas grup-moshave te atyre qe tejkalojne kohen e punes. Nga perpunimi i te dhenave del se eshte mosha 19-23 qe ka perqindjem me te madhe te pergjigjeve, ndersa me pas vjen mosha 24-28 vjec me 38 perqind.




Figura 22 tregon shperndarjen sipas aresimit te te rinjve qe tejkalojne kohen e punes. Te rinjte me shkolle te mesme edhe me 8-vjecare, jane qe tejkalojne me shume kohen e punes, perkatesisht zene 45% dhe 27% te totalit. Ndersa jane vetem rreth 1/3 totalit te te rinjve qe tejkalojne kohen e punes ata me aresim universitar.





Figura 23 tregon shpërndarjen sipas gjinise se atyre që tejkalojnë kohën e punës. Në këtë rast janë meshkujt ata që punojnë mbi kohën normale të punës, megjithatë në një përqindje jo shumë të ndjeshme nga të rejat përkatësisht 55 me 45 përqind.




Si konkluzion mund të thuhet se edukimi dhe moshën kanë një ndikim të ndjeshëm në kohën e punës së të rinjve, ndërsa gjinia në përgjithësi nuk është një faktor që ka ndikuar në variacionin e shpërndarjes së të dhënave midis dy grupeve sipas gjinise.

### 3.2. Analiza e pages

Analiza e pages është nga çështjet më të rëndësishme dhe ndoshta më e vështira, pasi në të mpleksen një sërë faktorësh që kanë të bëjnë me kushtet më të cilat janë vendosur, mundësitë e reja për levizur në tregun e punës, informacioni që ka për vendet e reja të punës etj.


Në figurat 24 dhe 25 tregohen përgjigjet në lidhje me raportin kohë pune-page-kohë e lire. Nëse diskutohen çështjet e pages të rinjtë janë më të vendosur për të kërkuar rritje page se sa me pak orë pune. Kjo gjë tregohet në figurën 24 ku 69% të intervistuarve deklarojnë se janë më të interesuar për rritjen e pages, kundrejt 24 përqind që mendojnë se duan me pak kohë pune. Vetëm 7 % janë të pavendosur.



Keto të dhëna tregojnë se megjithatë një pjesë e mirë e të rinjve punojnë më shumë se 5 ditë në javë (apo më shumë se 45 orë) dhe tejkalojnë në mënyrë të rregullt kohën e punës, ata përsëri janë më të interesuar për çështjet e pages se sa për kohën e tyre të lire.




Per me teper ne pyetjen e drejperdrejte se ne rast se ofrohet nje page me e larte a do te ndryshonin kohen e punes, te rinjte ne pjesen me te madhe deklarojne ne menyre pozitive. Keto te dhena paraqiten ne figuren 25, ku 88 % e te intervistuarve deklarojne se do te punojne me shume ne rast se ofrohet nje page me e larte, kundrejt vetem 12 % qe japin nje pergjigje mohuse.




Keto pergjigje disi kontradiktore ne dukje flasin me shume per nje treg pune te pa organizuar, ku informacioni per pagen dhe nevojat eshte mjaft i ulet gjë qe i ben te rinjte qe megjithese jane te okupuar ne me shume se 6 dite javes te kerkojne rritjen e kohes se punes kundrejt nje page me të larte.


Analiza e metejshme do te vijojte me paraqitjen me te hollësishme te dhenave sipas kategorive te ndryshme te te rinjve qe pranojne te punojne me shume kundrejt nje page me te larte. Ne figuren 26 tregohen se jane te rinjte e moshes 19-23 vjec qe pranojne te punojne me shume kundrejt nje page me te larte. Pas tyre me 39 % renditen te rinjte e moshes 24-28, dhe vetem 17 % të totalit e zene te rinjte e moshes 16-18 vjec.




Shperndarja sipas aresimit (figura 27) tregon se te rinjte me shkolle te mesme kane nje ambicje per nje page me te larte kundrejt dhenies me shume te kohes se lire, kundrejt dy grupeve te tjera. Kjo pasi jane 47 % te pergjigjeve qe i perkasin grupit te te rinjve me shkolle te mesme.



Shperndarja sipas gjinise se pergjigjeve tregon edhe ketu ka nje lloj barazbeshimi ku te rinjte meshkuj jane me te gatshem qe te lene nga koha e tyre e lire kundrejt te rejave. Figura 28 tregon perseri raportin 55 me 45 %.



Ne figuren 29 paraqiten te dhenat qe nderlidhin ceshtjen e pages me shfrytezimin e kohes se punes. Ne kete rast pyetja se cilat do te ishin ndryshimet e kohes se punes se tyre ekzistuese kundrejt nje page me te larte, ka me shume se nje opsion (pra totali eshte me i madh se 100 %). Nga figura duket se pjesa dermuese e te rinjve mendojne te sakrifikojne ditet e shtune per nje page me te mire, pasi e kane perzgjedhur kete opsion rreth 78% perqind e te intervistuarve. Vendin e dyte si drejtim me i preferuar ka zgjatja e oreve te punes me 66 perqind. Kuptohet se ne vendin e fundit nga preferenca eshte puna naten, te cilen me sa duket te rinjte do ta kishin te veshitore ta pranonin per nje kohe te gjate. Ndersa rreth 45 % e tyre kane theksuar se jane gjithashtu te gatshem te pranojne te punojne me shume ne cfardo opsioni qe do tu paraqitej per nje page me te larte.




Si perfundim mund te thuhet se nga analiza e te dhenave te deritanishme tregon se te rinjte ne marredhenie pune jane majft me te interesuar per nje page me te larte, kundrejt kohes se lire, duke pranuar te punojne edhe ne ditet e pushimit dhe ne orar me te zgjatur.


### 3.3. Gadishmeria per te kerkuar pune te re

Gadishmeria per te nderuar dhe levizur ne nje pune te re jane nga karakteristikat kryesore te nje tregu dinamik te fuqise punetore. Kjo pasi gadishmeria per te levizur ben te mundur qe fuqia punetore te shfrytezoje me mire aftesite e saj dhe se dyti i pershtatet me mire dinamikes se ndryshimeve ekonomike. Ne kete seksion do te shikohen pikerisht keto aspekte per grupet perkatese te rinise.


Ne figuren 30 tregohet se 83 % e te rinjve me kohe te plote pune nuk deshirojne te kene nje pune me kohe te pjeshme, dhe vetem 17 % tregojne se kane deshire nje kohe te pjeshme. Keto pergjigje jane ne perputhje me rezultatet e seksionit te meparshem, ku shumica dermuese e rinise ishin te gatshem te shtonin kohen e punes kundrejt diskutimit te ceshtjeve te pages.



Ndersa ne figuren 31 paraqiten rezultatet e nje pyetje mjaft te rëndesishme. Nga te rinjte qe jane ne maredhenie pune, vetem 39 % jane ne kerkim te nje pune te re ndersa 61% nuk pretendojne te ndryshojne vendin e punes.




Ne figuren 32 tregohet se nga te rinjte qe jane ne pune dhe kerkojne njekohesisht per nje pune te re, 60% kane kualifikim profesional dhe 40% nuk kane kualifikim, gje qe tregon se do ta kene te veshtire per te gjetur nje pune te re.



Treguesi me i rëndesishem i dinamikës së punës gadishmeria për të punuar në rajon tjetër larg qendrës së tij të banuar. Ky tregues i testuar për të rinjtë që janë në punë dhe kërkojnë punë të re paraqitet në figuren 33. Nga figura duket se 46% e të rinjve që janë në marrëdhënie pune theksojnë se nuk janë të gatshëm për të punuar në një rreth tjetër, dhe pjesa tjetër tregon se është e gatshme


Te dhenat e figures 33 dhe ato te figures 30 tregojne se tregu i punes per te rinjte tregon se nuk eshte fleksibel, kur dihet qe te rinjte jane ajo shtrese e popullsisë qe eshte me e gatshme per te levizuar dhe kerkuar pune te reja.



#### 4.1. Analiza e te papuneve qe nuk kerkojne pune

Faktoret qe ndikojne ne rritjen epo uljen e papunesise jane te shumte. Nga faktoret kryesore sigurisht eshte ecuria ekonomike, d.m.th. kerkesat e reja per vende pune nga sektoret e ndryshem prodhues dhe jo-prodhues (sektori publik). Megjithate, ne rastin e papunesise dhe sidomos te asaj kronike ka edhe mjaft faktore te tjere qe kane te bejne me vete tregun e punes, sic jane pershembull, kualifikimi, shkalla e informimit, gadishmeria per te punuar, arsimi, tradita apo edhe faktore te natyres me sociale dhe psikologjike te nje komuniteti te caktuar. Ne kete seksion do te trajtohen nje pjese e ketyre faktoreve, kuptimi dhe analiza e te cilave ndihmon per pregatitjen e politikave me efektive per zhdukjen e papunesise kronike apo afatgjate dhe integrimin sa me shpejt te rinise ne tregun e punes.

Fillimisht do te shikohet se nga totali i te rinjve qe eshte papune cila pjese eshte qe kerkon realisht pune dhe me vone do te analizohet se cpefaqeson ajo pjese e rinise qe eshte papune dhe nuk kerkon pune. Figura 34 tregon se nga totali i te rinjve qe jane pa pune vetem 71% jane duke kerkuar pune, ndersa 29% deklarojne se nuk kerkojne pune.



Treguesi i kerkimit per pune eshte nje tregues mjaft i rendesishem, pasi ky tregues korrigjon te dhenat qe kane te bejne pjesen totale te papunesise, duke llogaritur ne kete menyre papunesine reale (pasi ne kete tregues nuk merren parasysh ata qe jane papune dhe nuk kerkojne pune). Ne rastin e te anketuarve ne kete studim shifra e te papuneve ishte 28% (figura 5), atehere pupunesia reale per rastin e te rinjve ne kete interviste eshte afersisht 20%.

Analiza e metejsjme duhet te vazhdoje per te kuptuar se perse 29% e te rinjve papune nuk kerkojne pune, pasi ky eshte nje kontigjent mjaft i rendesishem dhe relativisht i madh, po te mendohet se e njejta mesatare do te rezultone ne rang kombetar.

Ne figuren 35 paraqiten te dhena mbi shperndarjen e te papuneve qe nuk duan pune sipas grup-moshave. Vihet re se 43% e zene te rinjte e grup-moshes 19-23 vjec, 37 % ata te moshes 24-28 vjec dhe diferenca ne moshen 16-18 vjec. Kjo shperndarje ne pergjithesi, i pergjigjet shperndarjes se pergjithshme te intervistuesve, keshtu qe nuk mund te terhiqet ndonje konkluzion nese mosha perben nje faktor qe ndikon ne mos kerkesen per pune.






Figura 36 tregon se 73 % e te rinjve qe jane papune dhe nuk kerkojne pune jane femra, kundrejt 27 % te meshkujve. Kjo eshte nje diference mjaft e madhe po te kemi parasysh qe ne te gjitha pyetjet e tjera gjinia nuk ka patur ndonje ndikim te vecante ne tregun e punes.



Duke e analizuar me ne thellesi kete fenomen, nga figura 37 shikojme se pjesa dermuese ose 68 % e femrave qe jane pa pune dhe nuk kerkojne pune jane me aresim 8-vjecar, ndersa pjesa tjeter ose 32 % me aresim te mesem. Sic shikohet te gjitha te rejtat qe kane mbaruar universitetin dhe jane pa pune jane duke kerkuar pune.




Ne kete rast eshte e qarte se aresimi eshte nje faktor determinat qe percakton deshiren e te Resë qe te mos kerkoje te ingranohet ne tregun e punes, dhe ne kete rast shqetesuese eshte per femrat me aresim 8-vjecar. Megjithate duhet theksuar se duhen bere analiza me te hollesishme se perse ky kontigjent nuk ka deshire per te punuar. Kjo gje mund te sherbeje si pjese nje studimi te vecante ne te ardhmen.

## 4.2. Karakteristikat e “rezervuarit” te te papuneve


Nje i papune quhet i papune kur nuk arrin te siguroje nje pune nje muaj mbasi ka pushuar marresheniet e punes. Ne vijim ne qofte se kalon mbi 6-muaj pa gjetur pune te re atehere i papuni konsiderohet nje kontigjent qe ka nevojte per kualifikim te vecante per te siguruar aftesite e nevojshme per te siguruar nje pune te re. Ne kete drejtim eshte e nevojshme te analizohet pikerisht koha qe kane qene te pa pune dhe karakteristika te tjera qe lidhen me “rezervuarin” e papunesise per te nxjere konkluzione per faktoret qe kane ndikuar dhe poltikat qe duhen ndermarre per ta ingranuar sa me shpejt kete pjese te rendesishme te popullsisë ne tregun e punes.

Informacioni i dhene ne figuren 38 tregon se 46 % e te rinjve kane qene vetem nje here te papune, 6% tregojne se ka qene dy here, ndersa 48% e tyre theksojne se kane qene tre here te papune.

Keto te dhena tregojne se te rinjte kane patur mjaft hyrje dhe dalje nga tregu i punes, pasi aferesisht gjysma e te rinjve te papune tregojne se kane qene me shume se tre here te papune.




Ne figuren 39 paraqiten te dhena mbi kohen totale qe kane qene te rinjte papune per me shume se nje muaj). Nga figura shikohet se 55% e te rinjve kane qene ne total me shume se dy vjet pa pune, 14% kane qene nga 1-2 vjet, ndersa vetem 21% e te rinjve kane patur me pak se 6 muaj ne total kohe papunesie.




Te dhenat e mesiperme tregojne qe nje pjese e konsiderueshme e rinise qe eshte e papune do te kete nevojte per kualifikim te ri ne menyre qe te integrohet sa me shpejt ne tregun e punes.

Ne figuren 40 paraqitet shperndarja e te rinjve te papune me shume se nje muaj ne 5-vjetet e fundit sipas grup-moshave. Eshte e qarte se perqindjen me te madhe do ta zene ata te moshes 24-28 vjec me 46%, ndersa ata te moshes 19-23 vjec zene 34% te totalit te rinjve me shume se nje muaj kohe papunesie.




Ne figuren 41 paraqet shperndarjen e te papuneve mbi nje muaj sipas edukimit. Perqindjen me te madhe e zene ata me shkolle te mesme me 48 %, ndersa te rinjte me aresim 8 vjecar jane 41 perqind te totalit dhe ata me aresim te larte vetem 11% te te rinjve qe jane pa pune me shume se nje muaj. Ne kete kuader me shume kujdes duhet treguar me te papunet me aresim te mesem dhe 8-vjecar.




### 4.3. Kualifikimi i te rinjve papune

Kualifikimi dhe rikualifikimi eshte nje aspekt tjeter shume i rendesishem per siguruar nje levizje normale brenda dhe jashte tregut te punes te te rinjve. Nga figura shikohet se me shume se gjysma e te rinjve, ose 58%, qe jane papune dhe kerkojne pune jane pa kualifikim profesional. Kjo kerkon nje vemendje te vecante pasi integrimi i ketyre te rinjve ne tregun e punes behet i mundur ne menyre te lehte nepermjet skemave te kualifikimit.






Pjesa e te rinjve qe deklarojne se kane kualifikim profesional deklararon se e kane fituar ate kryesisht nepermjet nje pune te caktuar (20%) dhe sidomos nepermjet skemave te kualifikimit dhe rikualifikimit (60%), cka e ben te nevojshem qe edhe keta te rinj te mund te kene kualifikime plotesuese per tu ri-integruar perseri ne tregun e punes. Figura 43 tregon gjithashtu se vetem 13% e te anketuarve kane perfunduar nje shkolle profesionale



**Legenda**

- 1. Trainim gjate punes se caktuar
- 2. Shkolle profesionale
- 3. Nga skema e kualifikimi dhe rikualifikimit
- 4. Te tjera


Figura 44 konfirmon pak a shume te dhenat e mesiperme, pasi vetem 23% e te anketuarve qe kane kualifikim profesional e kane kryer ate ne shkolla mbi 2 vjecare, pjesa tjeter kane zhvilluar kurse nen dy vjet.



**4.4. Menyrat e kerkimit te punes**

Nje ceshtje tjeter e rëndesishme eshte menyra se si kerkohet nje vend pune nga nje i ri qe kerkon pune. Ky aspekt eshte mjaft i rëndesishem, pasi ne mjaft vende te zhvilluara nje i papune konsiderohet si i tille, jo vetem kur ka deshien per te kerkuar pune, por edhe menyren se si e kerkon kete pune. Po keshtu ky problem eshte i lidhur me kanalet e informacionit si dhe institucionet dhe praktiket perkatese qe vendosen per te nderlidhur ate qe ofron pune me kerkuesin e punes. Per ta analizuar kete aspekt jane ndertuar dy pyetje, nje qe ka lidhje me menyren se si e kerkon informacionin dhe e dyta me menyren se si e kerkon punen.

Sipas figures 45 ndermjet pese opsioneve, ne 75% te rasteve te rinjte kane nenvizuar se e kerkojne informacionin per vendet e reja duke pyetur te njohurit dhe ne 12% te rasteve informacionin ja lene rastesise. Informacioni nga zyrat e punes dhe nepermjet shtypit eshte perzgjedhur perkatesisht nga 16% dhe 15%, ndersa interneti pothuajse eshte i paperfillshem si burim informacioni me vetem 1%.



**Legenda**


- 1. Lexoni lajmerimet e punedhenesve ne gazete
- 2. Kerkoni ne INETERNET
- 3. Pyetni ne zyrat e punes
- 4. Pyetni te njohur
- 5. Rastesia

Keto te dhena tregojne se kanalet informacionit per te kerkuar informacion per vendet e reja te punes jane pothuajse inekzistente dhe nuk kane ndonje ndikim te rendesishem tek te rinjte qe jane duke kerkuar pune. Me kete mund te shpjegohet ne nje mase te konsiderueshme dhe jofleksibiliteti dhe qendrueshmeria per nje kohe te gjate te te rinjve papune.

Ne figuren 46 paraqiten rastet se si te rinjte tentojne per tu punesuar. Nga figura shikohet se perseri ne 75% te rasteve te rinjte kane nenvizuar se ju drejtohen te njohurve per te ndermjetesuar per vend pune, ndersa i drejtohen drejtpersedrejti punedhenesve qe mendohet se kerkon pune ne 25% e tyre. Ndermjetesimi nepermjet zyrave te punes eshte perzgjedhur ne vetem 7% te rastve dhe 14% duke drejtuar kerkesa per lajmerimet ne gazeta.

**Legenda**


- 1. Beni njoftime ne gazete  
I drejtohen punedhenesit qe ka nxjerre njoftim
- 2. ne gazete  
I drejtohen punedhenesit qe mendohet se
- 3. kerkon pune
- 4. Aplikoni ne INTERNET
- 5. Mbani kontakte me Zyrat e Punes
- 6. Te njohur



Edhe ne kete rast shikohet se Rinia i ka shume te kufizuara kanalet e komunikimit duke perdorur ndermjetesine e te njohurve per te kerkuar nje pune te re.


**4.5. Fleksibiliteti per udhetuar ne nje pune te re**

Gadishmeria e te rinjve qe jane aktualisht pa pune per te punuar ne nje rreth tjeter paraqitet ne figuren 47. Nga figura duket se dicka me shume se gjysma e te rinjve qe jane aktualisht te papune nuk pranojne te shkojne ne nje rreth tjeter ne rast se ju paraqitet nje pune atje dhe vetem 48% pranojne te shkojne ne nje rreth tjeter.



Keto te dhena pergjithesisht flasin per nje treg pune relativisht jo fleksibel te fuqise punetore ne radhet e te rinjve, duke menduar se ata jane pjesa me gatshme e popullsise per te levizuar ne vendet ku krijohen vende te reja pune.

Ne figuren 48 jepen te dhena me te detajuara per largesine qe pranojne te udhetojne te rinjte larg qendres aktuale te banimit. Nga figura vihet re se nga te rinjte qe pranojne te udhetojne jashte rrethit, 26% e tyre pranojne te udhetojne jo me shume se nje ore nga qendra e tyre e banimit, 17% pranojne te udhetojne nga 1-2 ore dhe pjesa tjetere pra 57% pranojne te udhetojne mbi dy ore ne dite ne nje pune te re.



Shperndarja sipas moshes e te rinjve te papune qe duan pune dhe qe pranojne te shkojne ne nje rreth tjetere paraqitet ne figuren 49. Nga figura duket qarte se ka nje koralacion pozitiv ndermjet moshes dhe deshires per te punuar jashte rrethit. Kjo pasi pjesen me te madhe, ose 52% e zene te rinjte e moshes 24-28 vjec, ndersa vetem 14% te moshes 16-18 vjec pranojne te udhetojne jashte rrethit ne nje pune te re.




Figura 50 tregon shperndarjen sipas arsimit. Pjesa dermuese e te rinjve qe pranojne te shkojne ne nje rreth tjetere zene te rinjte me shkolle 8-vjecare dhe ata te mesme me 43% per sejcilin grup, ndersa te rinjte me universitet zene vetem 14%. Kjo shifer e ulet nuk flet per mos fleksibilitetin e te rinjve me universitet, por ata zene nje peshe me te vogel ne grupin e te rinjve pa pune.





Figura 51 tregon se meshkujt jane me te gatshem per te udhetuar ne nje rreth tjeter, kjo pasi pothuajse 80% e te anketuarve qe kane jane shprehur se pranojne te ushetojne jashte rrethit jane te rinj, kundrejt vetem 20% te te rejave. Keto te dhena konfirmojne edhe nje here nevojten per nje studim me te hollesishem në lidhje me studimin e nevojave dhe problematiken qe kane femrat per tu integruar ne pune, pasi ato kishin te dhenat me te larta per te mos kerkuar pune kur jane papune dhe qe nuk pranojne te levizin ne nje rreth tjeter ne te njejtat kushte papunesie.



Si perfundim mund te thuhet se “rezervuari” i papunesise ndermjet te rinjve eshte ne pergjithesi ne nje qetesi relative dhe jo dinamik, cka lidhet edhe me informacionin e ulet dhe kanalet pakta te komunikimit ndermjet punedhenesve te rinj dhe punemaresve private dhe publike.

## Kapitulli i peste Konkluzione dhe rekomandime

Ne lidhje me te rinjte qe jane marredhenie pune, u trajtuan 3 ceshtje kryesore: koha e punes, paga dhe fleksibiliteti. Konkluzionet kryesore per sejcilin problem jane keto:

### a. Per problemet e kohes se punes

1. Pjesa me e madhe e te rinjve te punesuar punojne mbi kohen normale punes (qe llogaritet ne rreth 40-45 ore ne jave), cka tregon se fleksibiliteti per te rritur kohen normale te punes ndermjet te rinjve aktualisht eshte i ulet. Nga kjo mund te rezultojte nje rritje e pages mesatare, ne rast se te papunet nuk gjejne rruget e duhura per tu integruar ne tregun e punes.
2. Niveli i arsimimit eshte ne perpjestim te zhdrejte me kohen e punes, d.m.th. sa me i ulet eshte niveli arsimor aq me e larte eshte perqindja e te rinjve qe punojne mbi 30 ore ne jave.
3. Duke krahasuar te dhenat mbi oret dhe ditet e punes ne jave mund te nxiren konkluzione, se te rinjte kryejne nje shfrytezim extensiv te kohes se punes se sa intensiv, ne kuptimin qe ata jane e ngarkuar me shume me dite pune gjate javes se sa ore pune gjate dites.
4. Edukimi dhe mosha kane nje ndikim te ndjeshem ne kohen e punes se te rinjve, ndersa gjinia ne pergjithesi nuk eshte nje faktor qe ka ndikuar ne variacionin te shpendarjes se te dhenave midis dy grupeve sipas gjinise.

### b. Per problemet e pages

1. Megjithese nje pjese e mire e te rinjve punojne me shume se 5 dite ne jave (apo me shume se 45 ore) dhe tejkalojne ne menyre te rregullt kohen e punes, ata perseri jane me te interesuar per ceshtjet e pages se sa per kohen e tyre te lire.
2. Tregu i punes eshte i pa organizuar, pasi informacioni per pagat dhe nevojat eshte mjaft i ulet qe i ben te rinjte qe megjithese jane te okupuar ne me shume se 6 dite javes te kerkojne rritjen e kohes se punes kundrejt nje page me ta larte.
3. Te rinjte me shkolle te mesme kane nje ambicje per nje page me te larte kundrejt dhenies me shume te kohes se lire, kundrejt dy grupeve te tjera.
4. Te rinjte ne marredhenie pune jane mjaft me te interesuar per nje page me te larte, kundrejt kohes se lire, duke pranuar te punojne edhe ne ditet e pushimit dhe ne orar me te zgjatur.

### c. Fleksibiliteti i te rinjve te punesuar

1. Tregu i punes per te rinjte tregon se nuk eshte fleksibel, kur dihet qe te rinjte jane ajo shtrese e popullsise qe eshte me e gatshme per te levizuar dhe kerkuar pune te reja.

Nga analiza e te rinjve pa pune dolen keto konkluzionet kryesore:

1. Niveli i arsimimit eshte ne perpjestim te zhdrejte me papunesine, pra sa me larte ne shkallen e edukimit ndoshen te rinjte aq me pak jane shancet per te qene te papune.
2. Ne kete rast eshte e qarte se arsimi eshte nje faktor determinat qe percakton deshiren e te rese qe te mos kerkoje te ingranohet ne tregun e punes, dhe ne kete rast shqetesuese eshte per femrat me arsim 8-vjecar.
3. Te rinjte kane patur mjaft hyrje dhe dalje nga tregu i punes, pasi aferesisht gjysma e te rinjve te papune tregojne se kane qene me shume se tre here te papune.
4. Te dhenat e mesiperme tregojne qe nje pjese e konsiderueshme e rinise qe eshte e papune do te kete nevojte per kualifikim te ri ne menyre qe te integrohet sa me shpejt ne tregun e punes.

5. Me shume kujdes duhet treguar me te papunet me aresim te mesem dhe 8-vjecar.
6. Kanalet e informacionit. Per te kerkuar informacion per vendet e reja te punes jane pothuajse inekzistente dhe nuk kane ndonje ndikim te rendesishem tek te rinjte qe jane duke kerkuar pune. Me kete mund te shpjegohet ne nje mase te konsiderueshme dhe jofleksibiliteti dhe qendrushmeria per nje kohe te gjate te te rinjve papune.
7. Edhe ne kete rast shikohet se rinia i ka shume te kufizuara kanalet e komunikimit duke perdorur ndermjtesine e te njohurve per te kerkuar nje pune te re.
8. Tregu i punes edhe per rastin e te puneve eshte relativisht jo fleksibel, duke menduar se ata jane pjesa me gatshme e populsise per te levizuar ne vendet ku krijohen vende te reja pune.
9. Pergjithesisht "rezervuari" i papunesise ndermjet te rinjve eshte ne pergjithesi ne nje qetesi relative dhe jo dinamik, cka lidhet edhe me informacionin e ulet dhe kanalet pakta te komunikimit ndermjet punedhenesve te rinj dhe punemaresve private dhe publike.

#### Rekomandime

1. Te shikohen me prioritet ceshtjet qe kane te bejne me rritjen e kanaleve te komunikimit ne tregun e punes.
2. Te rritet roli i zyrave te punes
3. Te mundesohet rritja e shkollave te kualifikimit te rinjve me aresimin 8-vjecar dhe te mesem
4. Te kryhet nje studim me i hollesishem per femrat te cilat nuk jane ne pune dhe nuk pranojne te kerkojne pune te re, apo levizin ne nje rreth tjetër.
5. Te ndiqen ne dinamike treguesit e punesimit dhe tregut te punes se rinise, nepermjet anketave vjetore, per te bere te mundur krahasueshmerine e rezultateteve.